



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:253813

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06487444

P.nr. 630/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, e me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Miranda Ibrahim, në çështjen penale kundër të pandehurit I. S. nga fsh. . . k-Gjakovë, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Gjakova PP/II.nr.1130/2024 te dt.28.10.2024 në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 19.11.2024 me pjesëmarrjen e Prokurorit Venera Shala, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij Av. Xhevdet Kendusi, me dt.19.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.21.11. 2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. S., data e lindjes . . . në Gjakovë nga fshatin . . .ku edhe banon Komuna Gjakovë, nga i ati B, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal . . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ESHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë 13.07.2024, rreth orës 22:10 në fsh. . . Komuna e Gjakovës, në magjistralen Deçan - Gjakovë, i pandehuri nga pakujdesia, duke vepruar në kundërshtim me nenin 50 par.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-186, drejton mjetin e tij . . ., ngjyrë e kaltër metalike, me targa të regjistrimit . . ., ku rrezikon pjesëmarrësit në komunikacion duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të rrugës ashtu që kur arrin në vendin e lartcekur humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, ashtu që fillimisht e godet një tabelë metalike në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes dhe pastaj me pjesën ballore të automjetit e godet në pjesën e pasme anësore të djathtë veturën . . . – e cila ishte e parkuar tek autolarja ". . .", nga e cila goditje pasagjeri – i dëmtuari A. J. pëson lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje në pjesën distale të ashtit të krahut (humerusit) të dorës së majtë të përshkruara si në Akt Ekspertizën Mjekoligjore të Dr. N. H. të datës 21.09.2024, ndërsa dëme materiale shkaktohen në veturën . . . prone e B. K..

Me këto veprime ka kryer veprën penale të Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par. 8 dhe par. 6 dhe lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, bazë te neneve: 7, 17, 38, 46, 47, 48, 49, 55, 69, 70, 370 par.8 lidhur me par.1 dhe par 6 të KPRK-së dhe neneve: 359, 360, 361, 365, 454, 463 të KPPK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N
ME DËNM ME KUSHT ME URDHER PER MBIKQYRJE NGA SHERBIMI
SPROVUES

- I. I përcakton dhe i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat për dy (2) vite, duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.
- I. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale.
- II. Dënimi me kusht do të mbikëqyret nga shërbimi sprovues.
- III. **URDHËROHET**, i pandehuri që të mbaj kontaktin me shërbimin sprovues, dhe i njëjti njoftohet se në rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund të revokoj dënimin me kusht.
- IV. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë me aktakuzën PP/II.nr.1130/2024 të dt.28.10.2024 ka akuzuar I. S. nga fsh. . . .k-Gjakove, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe të ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata themelore në Gjakovë me dt.19.11.2024 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale për cilën akuzohet, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim në procesverbal të shqyrtimit gjyqësorë konform nenit 242 të KPP-ës.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë nga ana e gjykatës

Gjykata paraprakisht të pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do të shpallet fajtorë për veprën penale të lartcekur, do të shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedure të provave.

Gjykata në bazë të nenit 242 paragraf 6 të KPPK pas marrjes së mendimeve të palëve lidhur me pranimin e fajësisë ku të gjitha palët kanë dhënë pajtimin që fajësia ti pranohet të pandehurit, gjyqtari pas një diskutimi me të pandehurin konform nenit 242 paragraf 3 të KPPK në lidhje me bazën faktike për pranimin e fajësisë, po ashtu duke u bazuar në faktin se i pandehuri i ka pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e

aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i akuzuari; dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata me aktvendim e ka miratuar pranimin e fajësisë.

Gjykata me pranimin e fajësisë në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I pandehuri me datë 13.07.2024, rreth orës 22:10 në fsh. . . . Komuna e Gjakovës, në magjistralen Deçan - Gjakovë, i pandehuri nga pakujdesia, duke vepruar në kundërshtim me nenin 50 par.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-186, drejton mjetin e tij . . . , ngjyrë e kaltër metalike, me targa të regjistrimit . . . , ku rrezikon pjesëmarrësit në komunikacion duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të rrugës ashtu që kur arrin në vendin e lartcekur humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, ashtu që fillimisht e godet një tabelë metalike në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes dhe pastaj me pjesën ballore të automjetit e godet në pjesën e pasme anësore të djathtë veturën . . . – e cila ishte e parkuar tek autolarja ”. . .”, nga e cila goditje pasagjeri – i dëmtuari A. J. pëson lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje në pjesën distale të ashtit të krahut (humerusit) të dorës së majtë të përshkruara si në Akt Ekspertizën Mjekoligjore të Dr. N. H. të datës 21.09.2024, ndërsa dëme materiale shkaktohen në veturën . . . prone e B. K..

Këto gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 251 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konform nenit 242 të KPPK-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare për veprën penale, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, por nuk i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar e ka dëshiruar por nga pakujdesia e të pandehurit gjatë vozitjes ka ardhur deri te ndodhja e ngjarjes, për veprimet e tilla të cilat përmbushen elementet e veprës penale të lartcekur, është përgjegjës, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për këtë veprë penale, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e kushtëzuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Identiteti subjektiv dhe objektiv i aktgjykimit me aktakuzën

Gjykata në baze të nenit 359 të KPPK konstaton se ky aktgjykim i referohet të pandehurit I. S. nga fsh. . . .k-Gjakove për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut

publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr.1130/2024 te dt.28.10.2024 të ushtruar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë.

Baza e aktgjykimit

Gjykata në bazë të nenit 360 të KPPK ketë aktgjykim e bazon vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor apo në rastin konkret që kemi të bëjmë me pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale me të cilën është akuzuar, i cili pranim fajësisë është në harmoni me provat që gjenden në shkresat e lëndës, e të cilin pranim fajësisë gjykata e ka pranuar me aktvendim në bazë të nenit 242 të KPPK, dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerre përfundim se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se është kryer vepra penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr.1130/2024 te dt.28.10.2024

Kryesi i veprës penale

Gjykata duke u bazuar në pranimin e fajësisë që i pandehuri ka bërë për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, i cili pranim fajësi ka qenë në harmoni me ligjin dhe provat në shkresat e lëndës ka konstatuar se i pandehuri është kryes i kësaj vepre penale.

Përgjegjësia penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 17 të KPK konsideron se i pandehuri në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë penalisht përgjegjës sepse ka qenë mendërisht i aftë, sepse në ato momente ka poseduar vetit psikike që i kanë bërë të mundshëm të kuptojnë rëndësinë e veprës penale, të kuptoj veprimet e tija, por veprimet i ka bërë pa dashjen e tij dhe pa vullnetin e tij që do të thotë se veprimet i ka ndërmarrë nga pakujdesia.

Fajësia dhe sanksioni penal

Gjykata duke u bazuar në faktet se është kryer vepra penale e lartcekura, veprën penale e ka kryer i pandehuri i cili është penalisht përgjegjës, gjykata e ka shpallur fajtor, pastaj gjykata ka konsideruar se nuk ka bazë që e përjashton nga përgjegjësia penale dhe as për lirim nga dënimi, andaj i ka shqiptuar sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në minimumin dhe maksimumin e paraparë ligjor në bazë të nenit 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, si dhe duke i pasur parasysh të gjitha rregullat e përgjithshme për matje të dënimit në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 70 të KPK, i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Qëllimi i dënimit

Gjykata në bazë të nenit 38 të KPK-ës ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallen e

rrezikshmërisë shoqërore, dhe ne këtë mënyrë do të ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit, si mase për parandalimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

Në bazë të nenit 55 të KPK-ës gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues sepse gjykata ka konsideruar se inkuadrimi i të pandehurit në shoqëri është më i lehtë dhe më i mirë përmes mbikëqyrjes nga shërbimi sprovës dhe e ka njoftuar të pandehurin se në rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund të revokoj dënimin me kusht.

Matja e dënimit

Meqenëse palët nuk ka kërkuar seance për caktim të seancës për matje të dënimit gjykata nga palët ka kërkuar që të deklarohen lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese të cilat do të ndikojnë lidhur me matjen dhe shqiptimin e dënimit.

Prokurori në shqyrtimin fillestar lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ka deklaruar se: konform nenit 235 par.1 prokurori i paraqet rrethanat lehtësuese lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, njëkohësisht kërkon të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij për veprën penale, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, meqenëse vepra penal është kryer nga pakujdesia e lë në vlerësim të gjykatës.

I dëmtuari A. J. pas konsultimeve të mjaftueshme me prindin e tij në shqyrtimin fillestar lidhur me rrethanat lehtësuese ka deklaruar se: I mbështetë rrethanat lehtësuese të deklaruara nga ana e prokurores së shtetit, dhe nuk parashtrojmë kërkesë pasurore-juridike.

I dëmtuari B. K. në shqyrtimin fillestar lidhur me rrethanat lehtësuese ka deklaruar se: I mbështetë rrethanat lehtësuese të deklaruara nga ana e prokurores së shtetit, dhe nuk parashtrojmë kërkesë pasurore-juridike.

Av. Xhevdet Kendusi mbrojtës i të pandehurit në shqyrtimin fillestar lidhur me rrethanat lehtësuese ka deklaruar **se**: sa i përket rrethanave lehtësuese, deklaron se ato që i përmendi prokurorja nuk po i përsërisë dhe qëndroj pranë tyre dhe shton se si rrethana lehtësuese të merren faktet, zotimin se nuk do të përsërisë më vepra të tilla, andaj i propozoj gjykatës që ti shqiptohet një dënim sa më i lehtë, e me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehurit D. D. në shqyrtimin fillestar lidhur me rrethanat lehtësuese ka deklaruar se: se e mbështet deklarin e mbrojtësit të tij,

Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje, është penduar, i gjendjes se dobët ekonomike dhe ka premtuar se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla, ka qen hera e pare qe ka ra

ndesh me ligjin, është i moshës se re, ndërsa rrethana rëndësuese gjykata nuk ka gjetur.

Kërkesa pasurore juridike

Gjkata nuk i ka udhëzuar të dëmtuarit në kontest civil sepse kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale

Gjkata në bazë të nenit 452 të KPP-së e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale dhe nga taksa për kompensimin e viktimave sepse i pandehuri është i pa pune, është i moshës se re, i gjendjes së dobët ekonomike dhe po të ngarkohej edhe me shpenzime të procedurës penale dhe me taksën për fondin për kompensim të viktimave të krimit do të rendohej edhe me tej gjendja ekonomike e tij

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, P.nr.630/2024 të dt.21.11.2024

Zyrtarja Ligjore

Miranda Ibrahim

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa **në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve** nga koha e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Gjakovë.